



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC**

Numri i lëndës: 2022:084075

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04855356

**PPP. nr. 30/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC**- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të Kreditorit H.A nga Komuna Gllogoc, kundër debitorëve G.G dhe B.G nga Komuna e Gllogocit, lidhur me borxhin në shumën prej 400.00 €, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitorët kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat E.M, P.nr... të datës 08.04.2020, jashtë seancës me datën 30.10.2023 gjykata e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** prapësimi i debitorëve G.G dhe B.G, nga Komuna e Gllogocit, ushtruar kundër urdhërit të Përmbartuesit Privat E.M, P.nr... të datës 08.04.2022, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit për përmbartimin e borxhit në shumën prej 400.00 €, ashtu që urdhëri i Përmbartuesit Privat E.M, P.nr... i datës 08.04.2022 **mbetet në fuqi**.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat E.M, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Pajtimit Gjyqësor C.nr... të datës 07.02.2022 i cili është i plotëfuqishëm, i cili sipas Nenit 21 dhe 22 të LPP-së paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit ndërsa në bazë të Nenit 29 par.1.2 të këtij ligji është dokument i besueshëm.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit, në afat ligjor debitori ka paraqit prapësim, me arsyetimin se: *është shkelur Neni 71 pika 1.6 i LPP-së pasi që kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartim në bazë të dokumentit përmbartues gjegjësisht nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartim kundër debitorit, dhe se debitorëve ju mungon legjitimiteti pasiv pasi lënda C. nr. 1047/21 të paditur ka qenë L... SH.P.K, e nuk ka qenë G.G dhe B.G. Gjithashtu edhe dokumenti në bazë të cilit kreditori ka paraqitur propozimin për përmbartim nuk përmban elementet e kërkuara me ligj dhe si i tillë është jo i plotë, andaj gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e tij si të bazuar.*

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilin ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se: *padia për pengim posedim ka qenë e parashtruar ndaj tri palëve L... SH.P.K, dhe G.G dhe B.G, kjo vërtetohet edhe në bazë të procesverbalit të seancës të datës 07.02.2022 në lëndën C.nr.1047/21 në të cilën është arritur pajtimi gjyqësor, pasi që qartësi shihen se janë tre persona të paditur, një person juridik dhe dy persona fizik, në bazë të ujdisë gjyqësore të negociuar dhe të arritur në seancën gjyqësore në mes të paditurve G.G dhe B.G dhe paditësit H.A tani kreditor është arritur ujdia gjyqësore/pajtim gjyqësor ku gjykata i ka obliguar të paditurit tani Debitorët G.G dhe B.G që të ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës në shumën prej 400 Euro, duke i propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e Kreditorëve dhe të vërtetoj urdhërin përmbarimor me nr. P.nr.120/22 i datës 08.04.2022 të përmbaruesit privat E.M.*

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit i datës 19.04.2022, është i pabazuar. Kjo për shkak se, në seancën gjyqësore të mbajtur me datën 07.02.2022 në lëndën C.nr. 1047/21 është arritur pajtimi gjyqësor, ku palët janë pajtuar që të paditurit tani debitorët të i largojnë mjetet e punës nga parcela kadastrale me nr. 37 të konstatuar si në ekspertizë të gjeodezisë, dhe janë pajtuar që debitorët G.G dhe B.G të i paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën prej 400 Euro deri me datën 31.02.2022.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke vendosur dhe atë duke u bazuar në Nenin 21 dhe 22 par.1 pika 1.1 pasi që pajtimi gjyqësor është dokument përmbarues, ndërsa sipas Nenit 23 par. 1 të LPP-së Vendimi apo Ujdia Gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një Ujdi Gjyqësore të arritur me datën 07.02.2022 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc ku debitorët kanë pranuar obligimin që del nga ky pajtim gjyqësor. Andaj, gjykata vendosi që të refuzoj prapësimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të Nenit 73 par 3 të LPP-së kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc**  
**Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr. 30/22 i datës 30.10.2023**

**Gj y q t a r i**  
**Astrit Gashi**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.